



Statistika e llogarive financiare – gjendjet tremujore, të dhënat e pakonsoliduara

Drejtoria për Statistikë
Njësia për statistikë të llogarive financiare
tetor 2024




Analizë e llogarive financiare – gjendjet në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024, sipas sektorëve dhe instrumenteve



Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare

- **Pozicioni negativ neto financiar** i ekonomisë vendase **në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024 është 573,9 miliardë denarë**, që paraqet thellim prej 17,3 miliardë denarë krahasuar me tremujorin paraprak. Krahasuar me fundin e vitit 2023 PNF-ja është thelluar për 41,2 miliardë denarë.
- Lidhur me treguesit relativ, **pozicioni negativ neto në tremujorin e dytë është 64% nga PBB-ja***, që paraqet përqendrim për 1,9 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak.

Totali i mjeteve financiare, detyrimet dhe vlera financiare neto - ekonomia nacionale (% e PBB-së)




* Të dhënat për PBB-në janë vjetore, burimi: Enti Shtetëror i Statistikave (njoftim nga 07.03.2024 dhe nga 04.09.2024), përveç të dhënave për PBB për vitin 2024 të cilat janë parashikime nga BPRMV.



Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare

- Analizuar nga aspekti sektorial, amvisëritë dhe sektori "i huaj" janë neto kreditorë dhe i financojnë sektorët tjerë në ekonominë kombëtare (ShJF dhe shteti), të cilët janë neto debitorë. Sektori financiar edhe më tutje ka një pozicion neto financiar pothuajse të balancuar.
- Nga pikëpamja dinamike, në bazë tremujore, thellësimi i VFN-së negative si % nga PBB-ja, rezulton nga pozicioni i përkeqësuar i shoqërive jofinanciare dhe shoqërive financiare, në kushte të pozitës neto të përmirësuar të amvisërive dhe shtetit.

Vlera financiare neto, sipas sektorëve (% e PBB-së)







Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare, sipas sektorëve

- Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024, **mjetet totale të ekonomisë kombëtare** shënojnë 3.995 miliardë denarë dhe arritën rritje tremujore prej 48,3 miliardë denarë, ose 1,2%, si rezultat i rritjes së totalit të mjeteve financiare të amvisërive, shoqërive financiare dhe shtetit.
- Lidhur me tremujorin e fundit të vitit 2023, totali i mjeteve të ekonomisë kombëtare shënojnë rritje prej 138 miliardë denarë, ose 3,6%. Ndryshimi në rritje është rezultat i rritjes së mjeteve të të gjithë sektorëve, kryesisht te amvisëritë dhe shoqëritë financiare.

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas sektorëve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Shoqëritë jofinanciare

Shoqëritë financiare

Shteti

Amvisëritë dhe NPISD

----- Ekonomia nacionale (boshti i djathtë)

Shoqëritë jofinanciare

Shoqëritë financiare

Shteti

Amvisëritë dhe NPISD


----- Totali i detyrimeve financiare




Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare, sipas sektorëve

- Në fund të tremujorit të dytë 2024, **totali i detyrimeve** arrin 4.569 miliardë denarë dhe realizuan rritje tremujore prej 65,6 miliardë denarë, ose 1,5%, si rezultat i rritjes së detyrimeve të të gjitha sektorëve, kryesisht te shoqëritë financiare dhe jofinanciare.
- Krahasuar me tremujorin e fundit të vitit paraprak, totali i detyrimeve shënon rritje prej 179,2 miliardë denarë ose 4,1%. Rritje të totalit të detyrimeve evidentohet te të gjitha sektoret, ku kontribut më të madh kanë shoqëritë financiare dhe jofinanciare, të ndjekura nga shteti dhe amvisëritë.

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas sektorëve (miliardë denarë)







Mjete financiare dhe detyrime të ekonomisë kombëtare, sipas instrumenteve

- Analizuar sipas instrumenteve, **në kahun e mjeteve** rritje më e madhe tremujore është shënuar te kapitali (26,7 miliardë denarë), kreditë (12,1 miliardë denarë), paratë e gatshme dhe depozitat (11,2 miliardë denarë), letrat me vlerë të borxhit (9,2 miliardë denarë) dhe kërkesat në bazë të sigurimit (4,4 miliardë denarë). Ulje ka vetëm te kërkesat tjera (17 miliardë denarë).
- Krahasuar me fundin e vitit 2023, rritje më e madhe shënohet te kërkesat në bazë të kapitalit (74,6 miliardë), të ndjekura nga kreditë (47 miliardë denarë) dhe letrat me vlerë të borxhit (34 miliardë denarë). Në bazë vjetore, rënie ka edhe te paratë e gatshme dhe depozitat (35 miliardë denarë).

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)







Mjetet financiare dhe detyrimet e ekonomisë kombëtare, sipas instrumenteve

- **Në kahun e detyrimeve,** rritje më të madhe tremujore vërehet te kapitali (38,9 miliardë denarë), kreditë (13,2 miliardë denarë) dhe paratë e gatshme dhe depozitat (12 miliardë denarë), derisa rënie është shënuar te detyrimet tjera (9,4 miliardë denarë).
- Krahasuar me fundin e vitit 2023, rritje më e madhe është shënuar te detyrimet në bazë të kapitalit (112,7 miliardë denarë) dhe kreditë (49,4 miliardë denarë). Instrumentet tjera kanë ndikim më të vogël në rritjen vjetore të detyrimeve. Rënie është shënuar vetëm te paratë e gatshme dhe depozitat (8,1 miliardë denarë).

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)






ANALIZA E TË DHËNAVE PËR LLOGARINË FINANCIARE SIPAS SEKTORËVE




Sektori i shoqërive jofinanciare (ShJF)

- **Vlera neto financiare** e sektorit ShJF në tremujorin e dytë të vitit 2024 është negative dhe shënon 1.097 miliardë denarë, që paraqet thellim tremujor prej 29,1 miliardë denarë, ose 2,7%. Lidhur me fundin e vitit 2023, pozicioni neto financiar është përkeqësuar për 6,2%.
- Analizuar nëpërmjet treguesve relativ, vlera financiare neto negative është 122% nga PBB-ja, që paraqet përkeqësim prej 3 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak.

Mjetet dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e SHJF






Sektori i shoqërive jofinanciare (ShJF)

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Ndryshimi tremujor** i totalit të mjeteve është negativ dhe është 2,4 miliardë denarë, ku rënie më e madhe shënohet te kërkesat tjera (19 miliardë denarë), derisa rritja shënuan kapitali (7,7 miliardë denarë), kreditë (6,4 miliardë denarë) dhe paratë e gatshme dhe depozitat (2,8 miliardë denarë).
- **Lidhur me fundin e vitit 2023**, mjetet totale të ShJF-së janë më të larta për 19,7 miliardë denarë, ku rritje më e konsiderueshme është realizuar te kapitali (19,8 miliardë denarë) dhe kreditë (13,1 miliardë denarë), derisa rënie ka te paratë e gatshme dhe depozitat (8,4 miliardë denarë) dhe te kërkesat tjera (4,7 miliardë denarë).




Sektori i shoqërive jofinanciare (ShJF)

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Në nivel tremujor,** totali i detyrimeve është rritur për 26,7 miliardë denarë, si rezultat i rritjes së kapitalit (21,9 miliardë denarë) dhe kredite (13,7 miliardë denarë). Ulje është regjistruar te detyrimet tjera (8,9 miliardë denarë).
- **Lidhur me fundin e vitit 2023** totali i detyrimeve është më i lartë për 84 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit (59,8 miliardë denarë) dhe kredive (23,9 miliardë denarë).




Borxhi i sektorit të ShJF-së

- Borxhi* i ShJF-së në tremujorin e dytë të vitit 2024 arrin 579,2 miliardë denarë, që paraqet rritje në raport me tremujorin paraprak prej 13,7 miliardë denarë, kryesisht shkaku i rritjes së huamarrjes së ndërmarrjeve nga sektori financiar.
- Nga pikëpamja sektoriale, ShJF-të pothuajse marrin hua në mënyrë të barabartë nga sektori financiar (bankat) dhe nga sektori i huaj, ndërsa pjesa më e vogël i takon huamarrjes ndërkompani.

Borxhi i shoqërive jofinanciare



Struktura e borxhit të shoqërive jofinanciare, sipas sektorëve




**) Në borxhin e ShJF-së dhe të sektorëve tjera në analizën, përfshihen instrumentet financiare: kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit*




Sektori amvisëri

- **Pozicioni neto pozitiv i amvisërive** në fund të tremujorit të dytë nga viti 2024 arrin 777,6 miliardë denarë. Në bazë tremujore është realizuar rritje prej 16,6 miliardë denarë, ose 2,3%, shkaku i rritjes më të madhe të mjeteve financiare për 24,8 miliardë denarë, në krahasim me rritjen e detyrimeve për 8,3 miliardë denarë. Lidhur me fundin e vitit 2023, vlera neto financiare e amvisërive arrin 6,7%.
- Lidhur me treguesit relativ, vlera financiare neto arrin 86,7% nga PBB-ja, që paraqet përmirësim tremujor për 1,8 p.p.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e amvisërive






Sektori amvisëri

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Totali i mjeteve të amvisërive në tremujorin e dytë është rritur për 24,8 miliardë denarë ose 2,4%, **në bazë tremujore**. Sipas instrumenteve, rritja vjen si rezultat i rritjes së parave të gatshme dhe depozitave (11,2 miliardë denarë), ndjekur nga kapitali (10,7 miliardë denarë), kërkesat në bazë të sigurimit (4,4 miliardë denarë), derisa te kërkesat tjera shënohet ulje (1,5 miliardë denarë).
- Në krahasim me **fundin e vitit 2023**, mjetet e amvisërive janë më të larta për 60,3 miliardë denarë, me kontribut më të madh të kapitalit (33,8 miliardë denarë), të ndjekur nga paratë e gatshme dhe depozitat (16,5 miliardë denarë) dhe kërkesat në bazë të sigurimit (8,6 miliardë denarë).




Sektori amvisëri

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në kahun e detyrimeve, **në tremujorin e dytë të vitit 2024** është realizuar rritje tremujore prej 8,3 miliardë denarë, ose 3,1%. Kjo është rezultat i rritjes së kredive (5,8 miliardë denarë) dhe detyrimeve tjera (2,4 miliardë denarë).
- Krahasuar me **fundin e vitit 2023**, totali i detyrimeve u rrit për 11,2 miliardë denarë ose 4,2%. Rritja rezulton nga rritja e kredive për 9,4 miliardë denarë dhe detyrimeve tjera për 1,8 miliardë denarë.




Borxh i sektorit "amvisëri"

- **Borxhi i amvisërive**, në fund të tremujorit të parë të vitit 2024 është 254,8 miliardë denarë, ose 28,4% nga PBB-ja, që paraqet rritje në krahasim me tremujorin paraprak prej 5,8 miliardë denarëve.
- Nga aspekti sektorial, huamarrja e amvisërive kryesisht bazohet në kreditë nga bankat, të cilat përbëjnë 94% të strukturës së borxhit, ndërsa një pjesë më e vogël i takon huamarrjes nga jashtë dhe nga sektori ITJ.

Borxhi i amvisërive



Struktura e borxhit të amvisërive, sipas sektorëve






Sektori "shtet"

- **Vlera neto negative financiare e shtetit** në tremujorin e dytë të vitit 2024 është 220,8 miliardë denarë dhe shënon përmirësim tremujor prej 782 milionë denarë (0,4%). Krahasuar me fundin e vitit 2023, vlera neto negative financiare është përmirësuar për 668 milionë denarë (0,3%).
- Analizuar sipas nënsektorëve, pozicioni neto negativ kryesisht është rezultat i nënsektorit "qeverisje qendrore", e cila ka VFN negative prej 26,2% nga PBB-ja. Vetëqeverisja lokale dhe fondet sociale kanë pozicion neto pozitiv financiar prej 1,2% dhe 0,3% nga PBB-ja, përkatësisht.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto






Sektori "shtet"

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në tremujorin e dytë të vitit 2024, totali i mjeteve të shtetit shënoi rritje **tremujore** prej 3,1 miliardë denarë, ose 0,9%. Kjo kryesisht vjen si rezultat i rritjes së kapitalit për 5,1 miliardë denarë, derisa depozitat shënojnë rënie prej 2,1 miliardë denarë.
- **Lidhur me fundin e vitit 2023**, totali i mjeteve shënoi rritje prej 18,5 miliardë denarë ose 5,4%. Rritja rezulton kryesisht në kërkesat bazuar në kapital prej 11 miliardë denarë, pastaj nga rritja e kërkesave tjera për 4 miliardë denarë dhe të parave të gatshme dhe depozitave për 3,4 miliardë denarë.




Sektori "shtet"

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Në anën e detyrimeve është shënuar rritje **tremujore** prej 2,3 miliardë denarë, ose 0,4%. Rritja rezulton nga rritja e detyrimeve në bazë të letrave me vlerë të borxhit 6,4 miliardë denarë, njëkohësisht me një ulje të detyrimeve tjera për 3,7 miliardë denarë.
- **Lidhur me fundin e vitit 2023**, totali detyrimeve u rrit për 17,8 miliardë denarë, ose 3,2%. Rritja kryesisht vjen nga rritja e letrave me vlerë të borxhit për 13,3 miliardë denarë dhe kredive 8,8 miliardë denarë. Ulje është shënuar te detyrimet tjera prej 3,8 miliardë denarë.




Sektori "shtet"

- Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2024, borxhi i shtetit arrin 53,4% nga PBB-ja, që paraqet rritje tremujore për 0,7 p.p.
- Në strukturën e borxhit dominon huamarrja jasht vendit, ku është shënuar rritje tremujore e borxhit të shoqërive financiare për 1 p.p., në llogari të rënies së huamarrjes jasht vendit.

General government Debt, % of GDP



Structure of the General government Debt, by sectors







Sektori "shoqëri financiare" (ShF)

- **Vlera neto financiare** e shoqërive financiare në tremujorin e dytë të vitit 2024 është negative dhe arrijnë 33,5 miliardë denarë, që paraqet përkeqësim për 5,5 miliardë denarë në raport me tremujorin paraprak. Vlera neto financiare është 3,7% nga PBB-ja, që është përkeqësim tremujor për 0,6 p.p.
- Analizuar sipas nënsektorëve, pozicioni i përkeqësuar neto financiar i shoqërive financiare është rezultat i rritjes së pozicionit neto negativ financiar të bankave, në kushte të përmirësimit të vogël të VFN-së të sektorit ITJ dhe të bankës qendrore.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto (% e PBB-së)






Sektori "shoqëri financiare" (ShF)

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- **Në nivel tremujor**, totali i mjeteve të shoqërive financiare shënon rritje prej 22,8 miliardë denarë, me kontribut më të madh të letrave me vlerë të borxhit (9 miliardë denarë), të ndjekura nga kredite (6,3 miliardë denarë), kapitali (3,2 miliardë denarë) dhe kërkesat tjera (3,1 miliardë denarë).
- **Lidhur me fundin e vitit 2023**, totali i mjeteve është më i lartë për 39,6 miliardë denarë me kontribut më të madh të letrave me vlerë të borxhit (34,5 miliardë denarë), kredive (33,5 miliardë denarë) dhe kapitalit (9,9 miliardë denarë), me rënie të parave të gatshme dhe depozitave (46,5 miliardë denarë).




Sektori "shoqëri financiare" (ShF)

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të detyrimeve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




- Totali i detyrimeve të shoqërive financiare shënon **rritje tremujore** prej 28,3 miliardë denarë, kryesisht si rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të kapitalit (17,3 miliardë denarë), parave të gatshme dhe depozitave (12 miliardë denarë) dhe sigurimit (4,4 miliardë denarë), me ulje të detyrimeve në bazë të kredive (6,1 miliardë denarë).
- **Në bazë vjetore** totali i detyrimeve është më i lartë për 66,2 miliardë denarë me pjesëmarrje më të madhe të kapitalit (53,4 miliardë denarë), i ndjekur nga detyrimet e sigurimeve (9 miliardë denarë) dhe kreditë (7,3 miliardë denarë), me rënie të parave të gatshme dhe depozitave (8,1 miliardë denarë).




Sektori "i huaj"

- Në fund të tremujorit të dytë, **pozicioni neto i sektorit "të huaj"** është pozitiv dhe arrin 573,9 miliardë denarë, që paraqet rritje prej 17,3 miliardë denarë lidhur me tremujorin paraprak, ose 3,2%. Ndryshimi i pozicionit neto pozitiv të sektorit "të huaj" rezulton nga rritja më e madhe e mjeteve financiare, krahasuar me detyrimet financiare.
- Lidhur me treguesit relativ, pozicioni neto pozitiv shënon 64% të PBB-së, që paraqet përmirësim për 1,9 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak.

Mjete dhe detyrimet financiare, % nga PBB-ja




Vlera financiare neto e sektorit jashtë vendit






Sektori "i huaj"

Ndryshimi tremujor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i totalit të mjeteve, sipas instrumenteve (miliardë denarë)




➤ Në tremujorin e dytë të vitit 2024 është realizuar rritje tremujore e **totalit të mjeteve financiare të sektorit të huaj** prej 19,9 miliardë denarë, pra 1,8%, kryesisht si rezultat i rritjes së kapitalit (14,7 miliardë denarë) dhe të kërkesave tjera (7,7 miliardë denarë).

➤ **Lidhur me fundin e vitit 2023**, është realizuar rritje prej 77,2 miliardë denarë, pra 7,3%, kryesisht si rezultat i rritjes së kërkesave në bazë të kapitalit (44,6 miliardë denarë), kredite (25,5 miliardë denarë) dhe kërkesat tjera (21,9 miliardë denarë), në kushte të uljes së kërkesave në bazë të letrave me vlerë të borxhit (8,1 miliardë denarë) dhe në bazë të depozitave (6,9 miliardë denarë).




Sektori "i huaj"

Ndryshimi tremujor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



Ndryshimi vjetor i detyrimeve totale, sipas instrumenteve (miliardë denarë)



➤ Në kahun e **detyrimeve financiare** është realizuar rritje tremujore prej 2,6 miliardë denarë, pra 0,5%, si rezultat i rritjes së detyrimeve në bazë të kapitalit, të arit monetar dhe SPV-së dhe të letrave me vlerë të borxhit në shumë totale prej 5,8 miliardë denarë, në kushte të uljes së detyrimeve në bazë të kredive për 3,1 miliardë denarë.

➤ Në nivel vjetor, **lidhur me fundin e vitit 2023**, është realizuar rritje prej 36 miliardë denarë, ose 7%. Rritja e totalit të detyrimeve kryesisht është reflektim i rritjes së detyrimeve në bazë të kredive (23 miliardë), të rritjes së detyrimeve tjera (22,8 miliardë) dhe të detyrimeve në bazë të letrave me vlerë të borxhit (12,9 miliardë). Ulje është shënuar vetëm te detyrimet në bazë të parave të gatshme dhe depozitave për 33,8 miliardë denarë.



Rishikim i të dhënave – seri kohore Tr.1 2022-Tr.1 2024

- Në tremujorin e dytë të vitit 2024, u zbatua rishikim i serisë kohore të të dhënave duke filluar nga tr.1 2022, shkak i shtrirjes dhe cilësisë më të mirë të të dhënave, e cila rezulton nga:
 - Të dhënat definitive të llogarive përfundimtare vjetore të subjekteve juridikë (shoqëritë jofinanciare dhe shteti) për vitin 2022;
 - Të dhëna preliminare të llogarive përfundimtare vjetore të subjekteve juridike (shoqëri jofinanciare dhe shteti) për vitin 2023. Rishikimi i referohet të dhënave për vitin 2023 dhe tr.1 2024 për të cilat si burim direkt përdoren të dhënat vjetore, për të cilat janë bërë vlerësime tremujore;
 - Rishikim i të dhënave të statistikave primare (rishikim i statistikave eksterne dhe rishikime të ITJ).



Rishikim i të dhënave – seri kohore Tr.1 2022-Tr.1 2024

- Rishikimet në vitin 2022 nuk sollën ndryshime të vlerës neto financiare të ekonomisë kombëtare, shkaku i rritjes së barabartë të mjeteve dhe detyrimeve financiare.
- Rishikimet në vitin 2023 dhe të tremujorit të parë të vitit 2024, sollën përmirësim të vlerës neto financiare të ekonomisë kombëtare, të shoqërive jofinanciare dhe të amvisërive, ndërsa deri në thellim të vlerës neto financiare të shtetit dhe shoqërive financiare.
- Efektet nga rishikimet janë të paraqitura në tabelën në vijim:

	milionë denarë				
<i>para revizionit</i>	<i>2023tr.1</i>	<i>2023tr.2</i>	<i>2023tr.3</i>	<i>2023tr.4</i>	<i>2024tr.1</i>
Ekonomia totale (S.1)	-524,203	-539,270	-536,908	-549,011	-563,272
Shoqëritë jofinanciare (S.11)	-1,004,530	-1,007,968	-1,015,916	-1,042,779	-1,069,831
Shoqëritë financiare (S.12)	-8,155	-3,562	257	-6,498	-26,777
Shteti (S.13)	-173,691	-198,257	-199,364	-218,333	-219,361
Amvisëritë dhe IJShA (S.14) + (S.15)	662,173	670,517	678,115	718,599	752,697
Vende të tjera (S.2)	524,203	539,270	536,908	549,011	563,272
<i>pas revizionit</i>	<i>2023tr.1</i>	<i>2023tr.2</i>	<i>2023tr.3</i>	<i>2023tr.4</i>	<i>2024tr.1</i>
Ekonomia totale (S.1)	-516,611	-525,779	-517,865	-532,731	-556,659
Shoqëritë jofinanciare (S.11)	-1,004,028	-1,002,781	-1,001,740	-1,032,845	-1,068,053
Shoqëritë financiare (S.12)	-8,360	-4,041	460	-6,886	-28,027
Shteti (S.13)	-174,659	-200,260	-202,526	-221,487	-221,601
Amvisëritë dhe IJShA (S.14) + (S.15)	670,436	681,303	685,941	728,487	761,023
Vende të tjera (S.2)	516,611	525,779	517,865	532,731	556,659
<i>dallimi</i>	<i>2023tr.1</i>	<i>2023tr.2</i>	<i>2023tr.3</i>	<i>2023tr.4</i>	<i>2024tr.1</i>
Ekonomia totale (S.1)	7,591	13,491	19,044	16,280	6,614
Shoqëritë jofinanciare (S.11)	502	5,187	14,177	9,934	1,778
Shoqëritë financiare (S.12)	-205	-479	203	-388	-1,250
Shteti (S.13)	-968	-2,003	-3,162	-3,155	-2,240
Amvisëritë dhe IJShA (S.14) + (S.15)	8,263	10,786	7,826	9,888	8,326
Vende të tjera (S.2)	-7,591	-13,491	-19,044	-16,280	-6,614